DEKRET
Nr.5089, datë 18.10.2006

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 24 dhe 19 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U rijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Martin Lekë Dushaj
2. Xhemalije Ymer Dushaj (Trimi)
3. Gentjan Martin Dushaj
4. Valbjon Martin Dushaj
5. Ukë Faslli Rizvani
6. Zane Feriz Rizvani (Berisha)
7. Florjan Ukë Rizvani
8. Manjola Ukë Rizvani
9. Enkejlejd Ukë Rizvani
10. Adriatik Ukë Rizvani
11.Arif Faslli Rizvani
12. Shpresa Adem Rizvani (Glloga)
13. Shpëtim Arif Rizvani
14. Edmir Arif Rizvani
15. Altin Arif Rizvani
16. Edmond Arif Rizvani
17. Faslli Arif Rizvani
18. Dorina Arif Rizvani
19. Muharrem Faslli Rizvani
20. Sadije Isuf Perizoviq (Bulaj)
21. Gëzim Beqir Perizoviq
22. Miraxha Gëzim Perizoviq
23. Mevlijeda Mehmet Perizoviq (Suma)
24. Mirsada Gëzim Perizoviq
25. Gëzim Enver Dibra
26.Valentina Mahmut Dibra (Mahmutaj)
27. Efigjeni Xhorxhi Piperi (Kole)
28. Mandita Dalip Lleshi (Shëngjergji)
29. Stela Luan Lleshi
30. Suada Luan Lleshi
31. Klodeta Luan Lleshi
32. Agim Anastas Ibrahimi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
PËR ZGJEDHJET E ARDHSHME PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Meqenëse së afërmi do të zhvillohen zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë;

Meqenëse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Kodi Zgjedhor ngarkon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me detyrën për të përgatitur, mbikëqyrur, drejtuar dhe verifikuar të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet;

Meqenëse Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në zbatim të Kushtetutës, legjislacionit shqiptar, si dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, ku shteti shqiptar është palë, është seriozisht i angazhuar për mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare;

Meqenëse për realizimin e këtyre standardeve kërkohet bashkëpunim serioz dhe i vazhdueshëm midis Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe strukturave shtetërore në varësi të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë;

Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që kanë këto zgjedhje për të ardhmen e vendit dhe në kuadër të marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian;

si dhe për të realizuar në shkallë institucionale këtë bashkëpunim;

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më poshtë referuar si Këshilli i Ministrave) dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (më poshtë referuar si KQZ-ja) nënshkruajnë këtë

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Palët në këtë Memorandum veprojnë në përputhje me statusin e tyre institucional, të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Zgjedhor dhe legjislacionin në fuqi.

Këshilli i Ministrave merr përsipër dhe i garanton KQZ-së që:

Nëpërmjet Ministrit të Financave

- Financimin e procesit zgjedhor sipas kërkesave të KQZ-së, si dhe mbështetje të menjëhershme me akte nënligjore për realizimin e procedurave të shpenzimeve buxhetore.

Nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë

- Krijimin e lehtësirave në lëshimin e vërtetimit të gjendjes gjyqësore të kërkuar nga subjektet politike apo individë në funksion të plotësimit të dokumentacionit ligjor për efekte zgjedhore.

- Gatishmërinë e gjykatave të shkallës së parë në gjykimin e shpejtë të ankesave të zgjedhësve në lidhje me përfshirjen e tyre në listën e zgjedhësve.

Nëpërmjet Ministrisë së Brendshme

- Asistencë në lidhje me sigurimin e ambienteve për zyrat e KZQV-ve, ambientet për VNV dhe KQV-të.

- Asistencë në lidhje me sigurimin e ambienteve për zyrat rajonale zgjedhore të KQZ-së.

- Sigurimin e ambienteve të nevojshme për zhvillimin e programeve të trajnimit që KQZ-ja do të organizojë për komisionerët e KZQV-ve dhe KQV-ve duke shfrytëzuar ambiente që janë në administrim të prefektëve ose njësive përkatëse të qeverisjes vendore sipas kalendarit të përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

- Asistencë në lidhje me shpërndarjen e bazës materiale zgjedhore dhe fletëve të votimit për çdo KZQV.

Nëpërmjet Ministrit të Mbrojtjes

- Asistencë në lidhje me transportin e bazës materiale zgjedhore dhe fletëve të votimit në bashkitë dhe komunat e vendit sipas grafikut të përcaktuar nga KQZ-ja.

- Vënien në dispozicion të KQZ-së për nevoja emergjente gjatë ditës së zgjedhjeve të një ose dy helikopterëve.

- Mbështetjen e KQZ me mjete të ndryshme transporti, mbi bazën e kërkesës së saj.

Nëpërmjet Ministrisë së Arsimit

- Sigurimin e ambienteve të ndryshme, kryesisht klasash mësimore dhe palestra shkollash për zhvillimin e seancave trajnuesve me komisionerët zgjedhorë, si dhe zhvillimin e procesit të numërimit të votave.

Nëpërmjet "ALBTELEKOM" sh.a.

- Asistencë me lidhjen me linjë telefoni dhe faksi të zyrave të KZQV-ve dhe VNV-ve në të gjithë vendin, duke mundësuar komunikimin e vazhdueshëm me KZQV-të, si dhe transmetimin e

rezultateve paraprake.

KQZ merr përsipër dhe i garanton Këshillit të Ministrave që:

- Në afatin e duhur do të nxjerrë aktet nënligjore të detyrueshme për zbatim nga organet jashtë zgjedhore.

- Do të identifikojë në nivel lokal ambientet e zyrave te KZQV-ve, VNV-ve, si dhe ambientet që mund të shërbejnë për zhvillimin e seancave trajnuese.

- Do t'iu sigurojë në kohë institucioneve të mësipërme informacionin e duhur për realizimin e bashkëpunimit institucional, në funksion të administrimit të procesit zgjedhor.

Për respektimin e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga ky Memorandum, palët veprojnë në bazë të kompetencave që u njeh ligji. Në këtë kuadër, palët njohin rolin drejtues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në procesin e përgatitjes së zgjedhjeve, si edhe angazhimin e posaçëm të strukturave të mësipërme, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Ky Memorandum Bashkëpunimi, hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 19.10.2006

Për Këshillin e Ministrave	Për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve
I ngarkuar	
Ilir Rusmali	Çlirim Gjata
Zëvendëskryeministër	Kryetar i KQZ-së